



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Bedri Elezi
Drejtor
Radio Kaçaniku
R044
Kaçaniku

Vendimi LIC: 2008/06
Ref: 0807/0997/CIMC/ni

VENDIM

lidhur me ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit të Radio Kaçaniku

Fakte

1. Parashtruesi i kërkesës është subjekt transmetues privat në Kaçanik. Ky subjekt transmetues ka pranuar licencën e modifikuar nga Komisioneri i Përkohshëm për Media më 31 maj 2005.
2. Më 26 nëntor 2008, Komisioni i Pavarur për Media ka pranuar një kërkesë nga drejtori i Radio Kaçaniku z. Bedri Elezi lidhur me ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit që gjendet në Rr. Dëshmorët e Kombit pn, për të kaluar në një lokacion të ri që gjendet në fshatin Bicaj.
3. Kërkësa për ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit është bërë me arsyetimin se Radio Kaçaniku nuk po arrinë ta mbuloj tërë zonën e licencuar me si pasojë pozitive gjeografike.

Arsyetimi

4. Në bazë të Ligjit Nr. 02/L-15 është themeluar Komisioni i Pavarur për Media dhe Transmetim i cili është autoriteti i vetëm në territorin e Kosovës për rregullimin e Spektrit të Frekuencave të Transmetimit, për lëshimin e licencave dhe mbledhjen e taksave për licencë transmetimi.
5. Inxhinieret e Divizionit të Menaxhimit të Frekuencave (DMF) të KPM-së, me 6 qershor 2008 kanë bërë një vizitë në Kaçanik dhe me këtë rast kanë marrë koordinatat e vendit në të cilin kërkon që ta vendos sistemin e transmetimit Radio Kaçaniku. Kështu që sipas analizave të bëra, përmes sistemit ATDI për të dy lokacionet e cekura në kërkesë nga inxhinierët të DMF-së vleronë se, ndryshimi i lokacionit të sistemit të transmetimit të Radio Kaçaniku, duke kaluar nga

Rruga Gazmend Zajmi #1, Prishtina - Gazmend Zajmi Street #1, Pristina - Ulica Gazmend Zajmi #1, Priština

lokacioni i licencuar vetem ne lokacionin e ri(fshati Bicaj) te propozuar ne koordinatat gjeografike N 42° 14' 77.1" dhe E 21° 13' 07.0" nuk do te ketë ndryshime në zonën e mbulimit të Radio Kaçaniku, dhe gjithashtu nuk paraqet ndryshime të Pjesës 2 dhe 4 të licencës së KPM-së.


6. Prandaj, DMF vlerëson se kalimi i Radio Kaçaniku në vendin e propozuar me anë të kërkesës dhe transmetimi në koordinatat e lartpërmendura është në pajtim me Kushtet dhe Termet e Licencës së KPM-së.
7. Komisioni i Pavarur për media e konsideron si te mjaftueshëm arsyetimin për ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit, nga ana e Radio Kacanikut.
8. Këshilli i KPM-së në pajtim me vlerësimin e lartpërmendur nxjerr këtë:

Vendim

9. Këshilli i KPM-së pajtohet me ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit të Radio Kaçaniku, duke kaluar nga lokacioni i licencuar i cili gjendet në Rr. Dëshmorët e Kombit pn, në lokacionin e propozuar me kërkesë i cili gjendet në fshatin Bicaj, sipas koordinatave të përcaktuara nga DMF.
10. Këshilli i KPM-së konkludon se me ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit nuk do të ketë ndryshime të Pjesës 2 dhe 4 të licencës së Radio Kaçaniku.
11. Këshilli i KPM-së pajtohet që Radio Kaçaniku të ndërrojë lokacionin e sistemit të transmetimit, përkohësisht deri në procesin e ri-licencimit.

Lëshimi i Vendimit


12. Këshilli i KPM-së lëshon këtë vendim.


Argjentina Grazhdani
Kryesuese e Këshillit të KPM-së.



07/14/2008
datë

Me këtë vërtetohet se Këshilli i KPM-së ka marrë këtë vendim në pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së KPM-së.


Naile Selimaj Krasniqi
Shefe Ekzekutive e KPM-së

14.07.2008
datë